



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 496/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rustem Thaçi dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 21.11.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa Anr.496/2019 e datës 20.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me të cilën ka kërkuar që një fletëvotim në Vendvotimin 0914E/01R, të shpallet i pavlefshëm dhe të obligohet KQZ - QNR, që këtë fletëvotim ta largoj nga votat e vlefshme të publikuar me rezultatin përfundimtar të datës 07.11.2019.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 20.11.2019, ka pranuar një ankesë Anr.496/2019 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se më datë 19.11.2019, rreth orës 12:30 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë numërimit të votave, konkretisht në kutinë e votimit 0914E/01R, është shpallur një fletëvotim i vlefshëm në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës Zgjedhore 06/2013, ku në fletëvotimin e kontestuar është shënjuar shenja “TIK”, në katrorin e subjektit politik “Nisma”, mirëpo me poshtë në mes të numrit 129- 130 ku janë të shënuara emrat e dy subjekteve, është shënuar një “ vizë-shënjim” e cila tejkalon shiritin nga numër 129 deri në numrin 130, gjithashtu në këtë fletëvotim ngjitur me numrin 111 është shënuar numër 2 me laps kimik. Me tutje paraqitësi në ankesë thekson se mënyra se si është bërë ky shënjim (vizë), duke shënuar edhe numrin 2 ngjitur me numrin 111 e bën të kontestueshëm dhe të paqartë qëllimin e votuesit, duke mos përjashtuar mundësinë se votuesi me atë shënjim të asaj vize ka votuar më shumë se për një subjekt politik, dhe se shenjat që janë vendosur në atë fletëvotim e bëjnë të pavlefshëm votën qytetarit përkatës, në përputhje me nenin 7 par.2 pika a) dhe b) të Rregullës Zgjedhore 06/2013 të KQZ-së. Për me tepër QNR në kutinë 1802X/01R, KQZ, ka shpallur një fletëvotim tjetër të pavlefshëm për arsye identike të lartcekura, vetëm pse njëri “tik” është vendosur në katrorin e 126 dhe një shënjim-vizë është vendosur në mes shiritit të numrit 120 dhe 121, pra jashtë katrorit të këtyre dy numrave, si dhe ngjitur me numrin 111 është shënuar numër 2 me laps kimik, pra KQZ ka përdorur kriteret e dyfishta edhe pse arsyet e shpalljes së vlefshmërisë së fletëvotimit në kutinë 0914E/01R, janë të njëjta me shpalljen e pavlefshme të fletëvotimit e cila gjendet në kutinë 1802X/01R, thuhet në ankesë. Paraqitësi në

ankesë kërkon që të urdhërohet KQZ, që të shpallë të pavlefshëm fletëvotimin e gjetur në kutinë 0914E/01R, dhe të njëjtën të mos përfshijë në rezultatin përfundimtar zgjedhor të shpallur me 07.11.2019.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është pjesërisht e bazuar**

Prendendimet e ankuesit se në Vendvotimin, 0914E/01R, gjendet një fletëvotim i kontestuar ku është shënuar shenja “TIK”, në katrorin e koalicionit NISMA-AKR-PD, mirëpo në mes të numrit 129 – 130 ku janë të shënuar emrat e dy subjekteve politike është shënuar një vizë-shënjim e cila tejkalon shiritin nga numri 129 deri te numri 130, dhe se në këtë fletëvotim ngjitur me numrin 111 është shënuar numri 2 me laps kimik, ku këto shenja e bëjnë të pavlefshëm votën e qytetarit përkatës, si dhe në vendvotimin 1802X/01R, KQZ ka shpallur të pavlefshëm për arsye identike të lartcekura, vetëm pse njëri “Tik”, është vendosur në katrorin 126 dhe një shënjim- vizë është vendosur në mes të shiritit të numrit 120 dhe 121, pra jashtë katrorit të këtyre dy numrave, si dhe ngjitur me numrin 111 është shënuar numri 2 me laps kimik.

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, brenda afatit ligjor kur ka kërkuar nga PZAP-i, që fletëvotimi në Vendvotimin 0914E/01R, të shpallet i pavlefshëm.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, Paneli konstatoi se nga hetimet e bëra në QNR, lidhur me këtë ankesë, ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i ankuesit lidhur me fletëvotimin në kutinë e votimit 0914E/01R, për arsye se nuk ekziston si Vendvotim ashtu siç është potencuar në ankesë.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.496/2019 më datën 21.11.2019**



**Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.**